

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Isa Kelmendi, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses Z.C., nga Komuna e ...,të cilën me autorizim përfaqëson R. A., av. nga Prishtina, kundër të paditurës KS''Siguria'', me seli në Prishtinë, lidhur me shpërblimin e dëmit material dhe jo material, duke vendosur përkitazi me revizionin e paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3157/2013 datë 28.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 10.tetor.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I PJESËRISHT pranohet revizioni i paditurës, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3157/2013 datë 28.03.2018 dhe ai i Gjykatës Themelore në Gjilan-dega në Kamenicë, C.nr.143/2009 datë 24.06.2013, që ka të bëjë me shpërblimin e dëmit jo material, ashtu që në emër të dhimbjeve fizike gjykohet shuma prej 5.000 €, në emër të frikës së përjetuar shuma prej 3.500 €, në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shuma prej 14.000 € .

II.Në pjesën tjetër revizioni i të paditurës refuzohet si i pabazuar.

III: Revizioni i paditëses hedhet poshtë si i palejuar.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan-dega në Kamenicë, C.nr.143/2009 datë 24.06.2013, është aprovuar kërkesëpadia e paditëses dhe është detyruar e paditura që paditëses Z.C., në emër të shpërblimit të dëmit material dhe jomaterial, t'ia paguajë shumat:

- në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 8,250 € ,
- në emër të frikës së përjetuar shumën prej 5,200 €,
- në emër të dhimbjeve shpirtërorë për zvogëlim të aktiviteti të përgjithshëm jetësor shumën prej 22,000 €, ndërsa
- në emër të dhimbjeve shpirtërore në emër të shëmtimit të shkaktuar shumën prej 3,500 €,ndërsa,
- në emër të dëmit material t'i paguaj
- në emër të shërimit klimatik(banjë) shemën prej 2,400.51 ,
- në emër të shpenzimeve të shërimit dhe blerjes së barnave shumën prej 22,481,799 €

Në emër të fitimit të humbur rentës së arritur për pagesë nga data 01.10.2005 e deri më datën 21.05.2013 shumën prej 15,089.80 € dhe prej datës 01.06.2013 e në ardhmen t'ia paguaj paditëses shumën prej 189,50 €,për muaj derisa ekzistojnë kushtet ligjore apo ndryshojnë rrethanat të caktuara me ligj.

Mbi shumën e gjykuar të kërkesëpadiës është refuzuar kërkesëpadia e paditëses dhe është vendosur si nën pikën III të këtij aktgjykimi

Është obliguar e paditura që të gjitha këto shuma t'ia paguaj me kamatë na lartësi prej 3,5 %, që paguajnë bankat në mjetet e deponuara mbi një viti, pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga data 24.06.2013, gjer në pagesën definitive si dhe t'ia paguaj këtu paditësit, në emër të shpenzimeve procedurale, shumën prej 1.994 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, me kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Gjykatës së Apelit pjesërisht pranohet ankesën e të paditurës dhe ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përkitazi për dëmin jomaterial, për dhimbje fizike gjykon shumën prej 6,000 € dhe frikës së pësuar gjykon shumën prej 4.500 € , si dhe vendimi mbi kamatën ashtu që detyrohet e paditura që të paguaj kamatën që paguajnë bankat në mjetet e deponuara mbi një viti, pa destinim të caktuar, të aktgjykimit të

goditur nga data 24.06.2013, nga dita e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë , gjerë në pagimin definitiv .

Kundër aktgjykimit në fjalë, në afatin ligjor ka ushtruar revizion paditësja për shkak aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë revizionin dhe ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së dytë, sa i përket dhimbjeve fizike të pësuar dhe të frikës së pësuar ose që aktgjykimi i gjykatës së shkallës ë dytë në këtë pjesë të ndryshohet dhe të lihet në fuqi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë si dhe kamata të llogaritet nga data e parashtrimit të kërkesës të e paditura për shpërblim dëmit .

Kundër aktgjykimit në fjalë, në afatin ligjor ka ushtruar revizion edhe e paditura për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë revizionin, dhe që të dy aktgjykimet t'i prishë dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur dhe shkresave të lëndës në pajtim me nenin 215 të LPK, ka gjetur se :

Revizioni i të paditurës, pjesërisht është i bazuar.

Revizioni i paditëses është e palejuar

Në procedurë të zhvilluar e cila ka paraprirë marrjen e aktgjykimit të goditur, në bazë të provave të administruara dhe vlerësimit të këtyre provave në kuptim të nenit 8 të LPK, është vërtetuar fakti se në aksidentin e komunikacionit që ka ndodhur më me datën 01.10.2005, në ra 13:50 në magjistralen Prishtinë –Gjilan , në fshatin Slivovë, automjeti të markës VW, me targë ..., i cili ka goditur automjetin Isuzi JEEP , të cilën ka drejtuar B. J., , ndërsa paditësja në këtë automjet ka qenë bashkudhëtare, me këtë rast paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore. Sipas aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prishtinë P.nr 428/06 të datës 03.04.2007,voztësi i automjetit VW, me targë ..., M. Sh., është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me kusht. Eksperti Dr. R. H., ortoped tramotolog ka bërë ekzaminimin e paditëses dhe ka vlerësuar se paditësja në këtë aksidente komunikacioni ka pësuar lëndime të renda trupore. Për shkak të aksidentit të komunikacionit paditësja ka pësuar dhimbje fizike intensitete posaçërisht të rënd ka zgjatur 2 orë e 40 minuta , intensiteti të rëndë ka zgjatur 3 ditë, ndërsa intensiteti të mesëm ka

zgjatur 3 muaj, ato të intensiteti të ultë manifestohen edhe sot e kësaj dite. Sipas mendimit të mjetit psikiatër A. C., është konstatuar se paditësja ka pësuar frik primar e cila ka zgjatur deri sa gjendja shëndetësorë e saj është stabilizuar. Frika intensitetit shumë të lartë ka zgjatur 2 ditë. Paditësja ka shëmtim shkallës ë mesme ,ndërsa aktiviteti jetësor është zvogëluar 40%„zvogëlim i aftësisë punuese është e përkohshme në shkallës prej 75 % nevoja për kujdes tuaj ka qenë në kohëzgjatje prej 4 vjet, ndërsa ushqim të përforcuar ka pas nevojë në kohëzgjatje prej 4 vjet , ndërsa shërimi klimatik ka qenë i nevojshëm 3 herë në vite nga ter javë e në këtë rast është bërë 6 herë dhe të gjitha fatura të parashtruar për shërim dhe barna ka qenë e nevojshme për paditëses ..

Isntituti i Mjekësisë ligjore me grupin e ekspertëve Dr.F. B., ekspert mjeko-ligjor ,Dr.N.D., Ortoped tarumatolog dhe Dr.M. H., Ortoped traumatolog ortoped tramotolog ka bërë ekzaminimin e paditëses dhe ka vlerësuar se paditësja në këtë aksidente komunikacioni ka pësuar lëndime të renda trupore. Për shkak të aksidentit të komunikacionit paditësja ka pësuar dhimbje fizike intensitete posaçërisht të rënd ka zgjatur 3, intensiteti të rëndë ka zgjatur 3 ditë, ndërsa intensiteti të Paditësja ka shëmtim shkallës ë mesme ,ndërsa aktiviteti jetësor është zvogëluar 50%, aftësia punuese është në vitin e parë në shkallë prej 100% ,ndërsa pas tri viteve 60%, nevoja për kujdes tuaj ka qenë në kohëzgjatje prej 6 muaj, ndërsa ushqim të përforcuar ka pas nevojë në kohëzgjatje prej 12 muaj, ndërsa për terapi fizikale ka patur nevojë 2 X 30 ditë vitin e parë dhe vitin e dytë 2X15 ditë ..

mesëm ka zgjatur 120 ditë, ato të intensiteti të ultë manifestohen edhe sot e kësaj dite .

Si pas vlerësimit të Gjykatës Supreme, shuma të gjykuara kanë nga ana e gjykatës instancës me të ultë që kanë të bëjnë lidhur me shpërblimin e dëmit jo material për dhimbje shpirtërorë për zvogëlim aktivitete të përgjithshëm jetësor, për dhimbje fizike dhe friken nuk janë adekuate dhe në përputhje me natyrën e shpërblimit e demit jo materia duke marrë parasysh rendisin e shkalles së të mirës dhe qëllimit që shërben ky shpërblim, si që është parapara me nenin 200 par. 1 dhe 2 të ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve . Kjo gjykatë duke pranuar pjesërisht revizionin e paditurës, e ndryshon aktgjykimin e Gjykatës së shkalles së dytë ashtu që në emër dhimbjeve fizike gjykon shumen prej 5,000 € , frikës së pësuar shumen prej 3,500 € në emër të aktiviteti të zvogëlimit të aktiviteti të përgjithshëm jetësor 14,000 €. Gjykata supreme këto shuma i gjykoj duke pasur parasysh moshën e paditëses në kohen kur ka pësuar aksidentit natyrën e lëndimeve, si dhe qëllimin e shpërblimit të dëmit jo material, kjo Gjykata konsideron se me ndihmën e

shumave të caktuara, paditësja mund të përjetoj një satisfaksion të konsiderueshëm për dhimbej fizike të pësuar, frik të pësuar dhe në emër dhimbjeve shpirtërore për zvogëlimin e aktiviteti të përgjithshëm jetësor. Një herit me rastin e caktimit të shumave për këto forma të dëmit material janë marrë parasysh dhe standardit jetësor i qytetareve të Kosovës por edhe praktiken e deri tanishme e gjykatave në Kosovë, prandaj kjo gjykatë gjykon shumat si në dispozitiv të aktgjykimit duke konsideruar e këto shuma reale dhe në përputhje me dispozita ligjore.

Thëniet e revizionit të paditurës se ekspertizat e ekspertëve, nuk janë ekspertiza bindëse, të papranuara nga arsyeja se ekspertët raportin e tyre kanë dhënë në bazë të dokumentacionit që gjenden në shkresat e lëndës dhe se me revizion nuk mund të paraqiten për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike.

Gjykata Supreme lidhur me shpenzimet procedurale vendosi që ato në tërësi t'i bartë e paditura në kuptim të nenit 453.3 të LPK, sepse në pjesën refuzuese nuk ka pasur shpenzime të veçanta. Sa i përket thënieve të revizionit se gjykata për shkallën e zvogëlimit të aftësisë punuese të paditëse është dashtë të angazhoj ekspertit e mjekësisë së punës, nuk qëndrojnë pasi që na rastin konkret kemi të bëjmë me lëndimet e pësuar në aksident të komunikacionit e jo me lëndime në punë dhe se nuk është e nevojshme angazhimi i ekspertit të Mjekësisë së punës.

Nga shkresat e lëndës rezulton se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk kalon shumë 3000 €. Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, pasi e shqyrtoi lejueshmërinë e paraqitjes së revizioni nga e paditësija, gjeti se i njëjti është i palejuar. Në kontestet për kërkesat në të holla nga marrëdhënie a punës, revizioni është lejuar nën kushtet e njejtë si në konteste pasurore - juridike të cilat kanë të bëjnë me kërkesat në të holla.

Sipas dispozitës së nenit 211.2 të LPK, revizioni nuk është i lejuar në kontestet pasurore-juridike, në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit ose me kryerjen e ndonjë veprimi, nëse vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur nuk kalon shumë 3000 €. Vlera e kontestit në pjesën e goditur është 2,950 €, e cila nuk kalon limitin e caktuar me ligj.

Nga arsyet e dhëna më lartë, u vendos si nën pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi me zbatimin e nenit 224.1 ndërsa u vendos si nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit me zbatimin e nenit 222 të LPK. Me zbatimin e nenit 221 të LPK, u vendos si nën pikën 3 të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.262/2018 më 10 tetor 2018

Kryetari i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri